



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republike of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 18 i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pasurisë së Paluajtshme Komunale, (Ligji nr. 06/L-092 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 03.04.2019), në bazë të nenit 18 dhe 19 të Rregullores së QRK-së 09/2020 për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 32 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr. 06 -103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur me dt. 25.06.2026 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

VENDIM

**PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM
TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE**

Neni I

EMËROHET komisioni i ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej:

1. Ellmedina Neziri – nga ekzekutivi,
2. Riad Isufi – nga ekzekutivi,
3. Sami Mejzini - anëtarë nga Kuvendi i Komunës,
4. Zgjim Fejza – anëtarë nga Kuvendi i Komunës,
5. Orhan Tosuni – përfaqësues i Sektorit joqeveritar “Renesansa”.

Neni II

Detyrë e komisionit është që të trajtoj ankesat në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, kontrollon punën e komisionit vlerësues etj. komisioni obligohet që ankesat të i trajtoj duke u bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Ligji nr.06/L-092), Rregullorës (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat tjera ligjore të cilat janë në fuqi.

Neni III

Kryetar i këtij komisioni është eksperti – i emëruari i parë ose eksperti të cilin e zgjedhin vetë anëtarët e këtij komisioni.

Neni IV

Administrata e Komunës është e obliguar që të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme me qëllim të efikasitetit të punës së Komisionit.

Neni V

Mandati i këtij komisioni është 2 vite në kuadër të mandatit të mbledhjes aktuale të Kuvendit të Komunës.

Neni VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës.

Neni VII

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024’’ dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-11872-5126

Dt. 25.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit:
Resul Fetahu

Resul Fetahu

